



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



14-111/01-0212742/18

Dt:05.09.2018

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe në harmoni me marrëveshjen e partneritetit në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Organizatës “Save the Children International” për mësimdhënësen mbështetëse për fëmijë me nevoja të veçanta, shpallë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës/e mbështetëse (ShFMU)

Lloji i Vendit të Punës: Me orar të plotë

Numri i Pozitës: Një (1) ekzekutues

Kohëzgjatja e emërimit: Në bazë të marrëveshjes së partneritetit në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Organizatës “Save the Children International”.

Detyrat dhe roli i mësimdhënësit/es mbështetës/se:

- Vrojtton në klasa të rregullta në bashkëpunim me mësimdhënësit klasor/kujdestarët klasor nxënësit e nivelit të ulët (posaçërisht faza kalimtare nga klasa para fillore në klasën e parë dhe nga klasa e pestë në klasën e gjashtë) për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore
- Mbështet nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë në klasa të rregullta
- Planifikon dhe organizon bashkë mësimdhënie me mësimdhënësin e rregullt në klasa ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore
- Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë klasës
- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësimdhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerët të ekipet të PIA dhe kur është e mundshme edhe vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore

- Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë
- Këshillon dhe ndihmon mësuesin dhe rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhojë me klasën gjithëpërfshirëse
- Harton materiale mësimore alternative bashkë me mësuesin dhe rregullt të cilat do të përdoren në mësuesin me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore
- Ndihmon në vetëdijesimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes
- Ndihmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore
- Bashkëpunon me Qendrat burimore për integrimin e fëmijëve me NVA nga Qendra Burimore në shkollë të rregullt përgatit dhe mbështet procesin e integrimin të fëmijës në klasë të rregullt.
- Bashkëpunon me mësuesin e klasës së bashkangjitur në shkollën ku punon dhe planifikojnë së bashku mbështetjen për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që janë në klasa të rregullta. Bashkë me mësuesin e KB bëjnë integrimin e nxënësve nga klasa e bashkangjitur në klasë të rregullt të atyre fëmijëve që janë të gatshëm me integrim
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimit, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në shkollë.
- Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të shkollës ku punon për punën e bërë

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 10/2018) marrëveshjes së partneritetit në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Organizatës “Save the Children International” për mësuesin mbështetëse për fëmijë me nevoja të veçanta si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësuesin/e mbështetës:

- Niveli Master, arsimit gjithëpërfshirës apo arsimit me nevoja të veçanta;
 - Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit- drejtimi përkatës;
 - Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë;
 - Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë speciale;
 - Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh.**

- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:

Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe

Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartçekura.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test dhe intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **05/09/2018 deri më datën 19/09/2018.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.